VENDIM
Nr.111, datë 4.3.1997

PËR TRANSFERIM TË FONDEVE BUXHETORE PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE USHTARAKE ME KUSHTE TË VËSHTIRA PËR VAZHDIMIN E VEPRIMTARISË PRODHUESE

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 11.2.1997 dhe me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet buxhetore të planifikuara për tremujorin e parë të vitit 1997 për Ministrinë e Mbrojtjes pakësohet shuma prej 50 milionë lekësh nga zëri "Shpenzime operative", e cila u shtohet fondeve buxhetore të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale në zërin "Përkrahja sociale e papunësisë".

2. Fondi prej 50 milionë lekësh do të përdoret në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 11.2.1997 "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtrake me kushte të vështira për vazhdimin e veprimtarisë prodhuese".

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi